



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada-Government**

**Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës**

*Ministarstvo za Kosovske Bezbednosne Snage / Ministry for the Kosova Security Force*

**Departamenti i Personelit/ Odsek za personal/Department for Personnel**



Në mbështetje të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin Nr.03/L-045 për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ligjin Nr. 03/L-82 për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, Rregulloren Nr. 13/2009 për Ngritjen në Gradën e Oficerit të FSK-së, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës shpall:

**KONKURSI BRENDSHEM**  
**PËR AVANCIMIN NGA GRADA E NËNOFICERIT NE GRADËN E OFICERIT**

**Avancimi;**

Avancimi bëhet në bazë të nivelit të përgatitjes profesionale, nivelit të përmbushjes së detyrave në të kaluarën, potencialit dhe nevojave të FSK-së. Pjesëtarët e FSK-së do të avancohen në gradë më të lartë nëpërmjet një procesi të drejtë dhe konkurrues, vetëm kur ka vende të përshtatshme të lira, kur rekomandohen nga autoriteti përkatës dhe kur t'i përmbushin kriteret për avancim të parapara me rregullore. Nuk ka avancime automatike në bazë të kohëzgjatjes së shërbimit në FSK.

**Të drejtat individuale të personelit të FSK-së:**

Pjesëtarëve të FSK-së u ofrohet trajtim i drejtë dhe i barabartë pavarësisht nga gjinia ose etnia, mundësinë për të pasur karrierë të plotë për të realizuar plotësisht potencialin e tyre përmes praktikës së emërimit, ngritjes në detyrë dhe zhvillimit në bazë një sistemi të përgjithshëm të meritave dhe transparences, çmohen dhe respektohen si individë dhe mbështeten e shpërblehen sipas rregullave dhe kushteve për shërbim.

**Kriteret për avancim;**

- Kandidatët duhet të kenë nivelin e duhur të arsimit (për oficerë të kenë diplomë universitare)
- Të kenë nivelin e duhur të trjanimit profesional;
- Të ketë të përfunduara raportet vjetore të vlerësimit;
- Të jenë rekomanduar për avancim në raportin vjetor të vlerësimit;
- Të mos kenë masa disiplinore nga Bordi Disiplinor;
- Të kenë të plotësuar standardet fizike dhe shëndetësore,
- Të identifikojnë gradën pozita dhe njësia për të cilën konkurrojnë
- **Kandidatët të cilët konkurrojnë për avancim nga grada e nënoficerit ne gradën e oficerit duhet të jenë para moshës tridhjetë e gjashtë (36) vjeçar, dhe duhet të kenë gradën OR-5 e më lartë.**
- 

**Dokumentet për konkurrim;**

- Diploma (dëshmi) e shkollimeve të përfunduara (për oficer të kenë diplomë universitare)
- Dëshmi, certifikata të trjanimave dhe kurseve
- Raportet e vlerësimit vjetor,
- Rekomandimin për avancim
- Raportin (të dhënat/dokumentin) disiplinor

**Si të aplikoni;**

Formularët e aplikimit për avancim janë në dispozicion në të gjitha njësit përkatësisht në Zyrat e Personelit, ku gjendet shpallja e konkursit. Formularët duhet të dorëzohen personalisht, në të gjitha Njësit (kazermat) e FSK-së, në çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim. Kandidatët duhet t'ia bashkëngjisin aplikacionit kopjet e dokumenteve që dëshmojnë përmbushjen e kushteve të nevojshme. Për informata plotësuese, mund të kontaktoni zyrat e personelit. Konkursi është i hapur 7 ditë pas shpalljes. Data e fundit e aplikimit është **09.11.2012**.

**Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës ofron trajtim të barabartë për të gjithë pjesëtarët e FSK-së dhe mirëpret aplikacionet e tyre për avancim në FSK-së, pa dallim nga përkatësia etnike apo gjinore.**